

UDHËZIM
Nr.27, datë 17.9.2009

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 9.9.2009 TË
MASH-IT “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E
PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2009 - 2010”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.864, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimiit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010”, të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar dhe të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 7.1. të udhëzimit të MASH-it nr.25, datë 9.9.2009 “Për procedurat e pranimiit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009–2010”, të shtohen si data regjistrimi: 19 e 20 shtator 2009.

2. Në fund të pikës 7.2.b të udhëzimit nr.25, datë 9.9.2009, të cituar më sipër, të shtohet fjalia:

a) “...Në mungesë të letërnjoftimit ID dhe të pasaportës, certifikatë lindjeje me fotografi.”.

3. Pika 8 e udhëzimit nr.25, datë 9.9.2009, e cituar më sipër, ndryshon si më poshtë vijon:

a) “Institucionet publike të arsimit të lartë, deri në orën 18.00 të datës 21.09.2009, të dorëzojnë në MASH dhe në APRIAL, listën origjinale të përgatitur nga APRIAL-i, me regjistrimet paraprake të kryera, në formë të shkruar dhe elektronike, në dy kopje, sipas udhëzimit të përgatitur nga APRIAL-i.”.

4. Ngarkohen zëvendësministri i Arsimit dhe i Shkencës, Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, APRIAL, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj